



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-061

Prishtinë, më 25 maj 2016, në orën 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, Kabineti i Kryetarit

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 25 MAJ 2016

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Slobodan Petroviq dhe Fikrim Damka, nënkryetarë të Kuvendit.

Munguan: Sabri Hamiti dhe Aida Dërguti, nënkryetarë të Kuvendit.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Avni Bytyçi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi dhe Sali Rexhepi.

Mbledhjen e drejtoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me pikat e rendit të ditës, si në vijim:

1. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesat e Kuvendit të Kosovës për rishikimin e Buxhetit për vitin 2016

Kryetari i njoftoi të pranishmit me rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa që kërkesat e Kuvendit të Republikës së Kosovës të përfshihen në rishikimin e Buxhetit për vitin 2016.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me rekomandimin e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesat e Kuvendit të Kosovës për rishikimin e Buxhetit për vitin 2016, në shumë prej 509 000 euro, dhe atë:

a) Programi “Anëtarët e Kuvendit” të shtohet shuma prej 210 000 euro, sipas kategorive në vijim:

- Në kategorinë “Mallra dhe Shërbime” të shtohet shuma prej 150 000€.
- Në kategorinë “Subvencione dhe Transfere” të shtohet shuma prej 60 000€.

b) Programi “Administrata e Kuvendit” të shtohet numri i të punësuarve prej 4 dhe shuma prej 239 000 euro, sipas kategorive në vijim:

- Në kategorinë “Paga dhe Mëditje” të shtohet shuma prej 10 000€.
- Në kategorinë “Investime Kapitale” të shtohet shuma prej 229 000€ për projektet në vazhdim:

- “Renovimi i ndërtesës dhe instalimeve ekzistuese” në shumë prej 200 000€

- “Sistemi i Menaxhimit të Objektivit” në shumë prej 29 000€.

c) Programi “Stafi Mbështetës Politik” të shtohet shuma prej 60 000€ në kategorinë “Mallra dhe Shërbime”.

3. Ministria e Financave duhet t’i përfshijë kërkesat e Kuvendit të Republikës së Kosovës në rishikimin e Buxhetit për vitin 2016.

2. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për lejimin e ekspertizës së jashtme lidhur me hartimin e Rregullores së re të Kuvendit të Kosovës

Kryetari i njoftoi të pranishmit me kërkesën e komisionit të lartshënuar për lejimin e ekspertizës së jashtme për hartimin e Rregullores së re të Kuvendit.

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për lejimin e ekspertizës së jashtme lidhur me hartimin e Rregulloreve të re të Kuvendit të Kosovës.
2. Kompensimi për angazhimin e ekspertëve të jashtëm lidhur me kërkesën e lartshënuar të bëhet sipas Udhëzimit për administrimin e buxhetit të komisioneve parlamentare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 04-V-025, datë 19 prill 2011.

3. Shqyrtimi i kërkesës për lejimin e udhëtimit zyrtar në Holandë

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i anëtarëve të Komisionit për Integritet Evropian, në këtë përbërje: Slobodan Petroviq, Luljeta Veselaj-Gutaj dhe Time Kadrijaj, për të marrë pjesë në takimin e 55 të Konferencës Parlamentare të Komisioneve për Bashkimin Evropian (COSAC), i cili do të mbahet në Hagë (Holandë), nga data 11-15 qershor 2016.
2. Shpenzimet e udhëtimit, akomodimit (me tejkalim në bazë të rezervimit paraprak), si dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

4. Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Danush Ademi për lejimin e udhëtimit zyrtar në Shqipëri, nga data 19-21 maj 2016

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Lejohet kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit, akomodimit dhe i mëditjeve për deputetin Danush Ademi lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Shqipëri, prej 19-21 maj 2016.

5. Njoftimi i Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Turqi

Kryesia u njoftua për vizitën zyrtare të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, të realizuar në Turqi, nga data 10-14 prill 2016.

6. Njoftimi i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Holandë

Kryesia u njoftua për vizitën e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Holandë, nga data 3-5 prill 2016.

7. Njoftimi i deputetes së Kuvendit, znj. Blerta Deli-Kodra, lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Bullgari

Kryesia u njoftua për vizitën zyrtare të deputetes Blerta Deli-Kodra, të realizuar në Bullgari, nga data 13-14 maj 2016.

8. Shqyrtimi i kërkesës për mbulimin e shpenzimeve lidhur me organizimin e Konferencës Ndërkombëtare Ndërfetare

Kryetari i njoftoi të pranishmit për rëndësinë e organizimit të Konferencës së 5-të Ndërkombëtare Ndërfetare, e cila organizohet nga Instituti Ndërkombëtar për Dialog Ndërfetar, me mbështetjen e Ministrisë së Jashtme e Kosovës, në të cilën do të marrin pjesë aktivistë të shoqërisë civile, udhëheqës fetarë, diplomatë, gazetarë, artistë dhe akademikë.

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet kërkesa për mbulimin e shpenzimeve lidhur me organizimin e Konferencës së 5-të Ndërkombëtare Ndërfetare, e cila do të organizohen në Kosovë prej datës 31 maj deri më 2 qershor 2016, për dy dreka, një pritje dhe një darkë për 200 pjesëmarrës.

9. Shqyrtimi i kërkesës për mbulimin e shpenzimeve lidhur me organizimin e “Lutjeve të Mëngjesit”

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa për mbulimin e shpenzimeve për organizimin e “Lutjeve të Mëngjesit”, të cilat do të organizohen në Kosovë, prej 18-26 qershor 2016, si në vijim:

- Mbulimi i shpenzimeve të fjetjes për 10 dhoma dhe shpenzimet për dreka, njëra në Mitrovicë dhe tjetra në Prizren, për 250 pjesëmarrës.
- Blerja e pesë (5) filigranëve, si dhe librit “Nëna Terezë”.

10. Shqyrtimi i kërkesës për mbulimin e shpenzimeve lidhur me organizimin e konferencës për prezantimin e punimeve “Rastet studimore për Trepçën”

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa për mbulimin e shpenzimeve për organizimin e konferencës për prezantimin e punimeve “Rastet studimore për Trepçën”, e cila do të mbahet më 4 qershor 2016, si vijon:

- Shpenzimet për sallën e konferencës, koktejin, drekën dhe darkën,
- Shpenzimet e udhëtimit për tre pjesëmarrës, njëri prej Turqisë - bileta e aeroplanit, ndërsa për dy tjerë shpenzimet e udhëtimit prej Bullgarisë dhe Shqipërisë (karburanti),
- Shpenzimet e fjetjes për katër persona për një natë, ndërsa pjesëmarrësit nga Turqia dy net.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 14:40 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale